

Data 31.07.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Sistemim Asfaltim Rruga Shen Pali e Shen Pjetri (Bajze)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime shtrimi dhe asfaltimi - 45233222-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

7 325 812 (shtate milion e treqind e njetzet e pese mije e teteqind e dymbjedhete)lek pa TVSH dhe 8 790 974 (tete milion e shtateqind e nentedhete mije e nenteqind e shtatedhete e kater) lek me tvsh.

Për vitin 2023: 1 990 974 (nje milion e nenteqind e nentedhete mije e nenteqind e shtatedhete e kater) lekë me tvsh.

Për vitin 2024: 3 500 000 (tre milion e peseqind mije) lekë me tvsh.

Për vitin 2025: 3 300 000 (tre milion e treqind mije) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madheka hartuarprocesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas Shtojces 7.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2020- 2021 - 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit . Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilanci të njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020- 2021 - 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. . (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe

VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar ne Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.3.Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1Për të provuar përvojën e mëparshmeofertuesi duhet të dorezojë:

1- Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vleres limit te objektit qe prokurohet, të realizuar gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Ose

2- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e objektit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur ne rendesine e objektit te prokurimit, vleren e fondit limit te vene ne dispozion , tipologjine e punimeve te ndertimit etj.

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

a. License profesionale sipas modelit të leshuar nga Ministria perkatese, sipas legjislacionit ne fuqi, e vlefshme me kategorite:

NP- 1 A “Punime gërmimi në tokë”

NP- 4 A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale”.

NS- 8 A “Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.”

NS- 18 A “Punime topogjeodezike.”

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë perkatese sipas legjislacionit ne fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe tëligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Përlicencat, autorizimetdhelejtnëRepublikën e Shqipërisë", tëndryshuar, dhetënenit 18, tëligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Përkontrollindhedisiplinimin e punimevetëndërtimit", tëndryshuarsiedheVendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteretdheprocedurat e dhenies se licencaveprofesionaletezbatimit, klasifikimitdhedisiplinimittesubjektevejuridike, qeushtrrojneveprimtarindertimi", pikat e licencesdhekatgorite me klasifikimetperkatesecaktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektitdhenevlerentotaletepunimeve per secilenkatgori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente .

Kategoritë e kërkuara janëkërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve sipas preventivit bashkengjitur DST dhe konkretisht:

Nr.	Kategoria e lic.	Zerat ne preventiv
1	NP- 1 A	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.1 Seksioni ”Punime ne kanal” Zeri nr.1
2	NP- 4 A	Sipas llojit te objektit- Rrugë , autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale..
4	NS- 8A	Seksioni ” Punime ne trotuar” Zeri nr. 2
5	NS-18 A	Sipas llojit te objektit, i nevojshem per rilevimin e objekteve

2.3.3 Ofertuesi duhet te jete i pajisur me Certifikate:

ISO 9001:2015 - Certifikate per sistemimin e menaxhimit te Cilesise;

ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës, dhe në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen.

Në rast bashkimi operatorësh, këto certifikata duhet të ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve që merr për shpër në akt-marreveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 20 (njëzet) punonjës (numër i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e punimeve në kohë, sipas analizës, bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve), për periudhën Prill 2023 – Qershor 2023. Kjo do të vërtetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën përkatëse;

-Listë pagesat e punonjësve për periudhën përkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore (në formë elektronike);

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualitetekniktecmimevetepunimevetendertimitdheteanalizavetekniketetyre “(perllogaritja e orevePunesiedhetemjeteveve nevojshme), KodiiPunes ne RSH, si dhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa më shpejt të objektit dhe konkretisht rezultojnë 12 punetore të thjeshtë numer i cili duke u mbledhur me drejtuesit teknik dhe personelin mbështetës sipas pikës 2.3.6 japin numrin 20.

2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë drejtues teknik në licencën e zbatimit të punimeve, të pakten:

- a. 1 (nje) Ing. Ndertimi
- b. 1 (nje) Ing. Topograf/Gjeodet

Per drejtuesit teknik si me lart, ofertuesi duhet te paraqese kontratat e punes, diplomat dhe CV.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.5 jane ne perputhje me licencat e kerkuar ne piken 2.3.2.

a. 1 (nje) Ing. Ndertimi (Ne preventiv parashikohen punime germimi dhe punime shtresash asfaltbetoni)

b. 1 (nje) Ing.Gjeodet (i nevojshem per rilevimin e objektit).

2.3.6. OE ofertuesi duhet te kete te perfshire ne stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen Prill 2023 – Qershor 2023, jo me pak se:

a. Teknik ndertimi 1 (nje)

b. Karpentier 1 (nje)

c. Hekurkthyes 2 (dy)

d. Hidraulik 1 (nje)

f. Pllakashtrues 1 (nje)

Per punonjesin teknik ndertimi duhet te paraqitet kontratat e punes , cv, dokumenti certifikues i siperperkerkuar dhe dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome).

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet

teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjësit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

a. Teknik ndertimi 1 (nje) Per te kontrolluar punen ndertimore dhe per te dhene udhezime te ndryshme per punimet)

b. Karpentier 1 (nje) (Per te kryer punimet armaturave) - Seksioni ”Punime ne trotuar” Zeri nr.3.

Seksioni ”Punime ne kanal” Zeri nr.6.

c. Hekurkthyes 2 (dy) (Per te kryer punimet e hekurit) Seksioni ”Punime ne kanal” Zeri nr.7,8.

d. Hidraulik 1 (nje) (Per te kryer vendosjen e tubave HDPE) Seksioni ”Punime ne kanal” Zeri nr.4,5.

f. Pllakashtrues 1 (nje) Seksioni ”Punime ne trotuar” Zeri nr.4.

2.3.7. OE ofertuesi duhet te kete te perfshire ne stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues), jo me pak se:

a. Manovratore 3 (tre)

b. Shofer 3 (tre)

Per keta te paraqiten kontratat e punes , cv dhe dokumenti certifikues i siperperkerkuar.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në

dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjësit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

a. Manovratore 3 (tre)- per drejtimin e mjeteve: Eskavator, Grejder, Rul me vibrim (2), Rul me kompresor, asfaltoshtruese, vinç, sipas rendit te puneve

b. Shofer 3 (tre) – per drejtimin e mjeteve kamion (2) , autobot dhe autobitumatrice, sipas rendit te puneve.

2.3.8 Dëshmi për makinerite dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte (ne pronesi ose me qira):

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja	Pershtatshmeria me preventivin (Justifikimi)
1	Eskavator me goma 0.25m3	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.1 Seksioni ”Punime ne kanal” Zeri nr.1
2	Kamion me veteshkarkim min. 10 ton	2 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.2.3.8/ Seksioni ”Punime ne kanal” Zeri nr.1,2
3	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.5,6.
4	Rul me vibrim	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.5,6.
5	Autobot uji	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.6.
6	Rul me Kompresor	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.7,8.
7	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge” Zeri nr.7,8.
8	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni ”Punime ne rruge”

				Zeri nr.7,8.
9	Vibrator Thellesie	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni "Punime ne rruge" Zeri nr.9. Seksioni "Punime ne trotuar" Zeri nr.3. Seksioni "Punime ne kanal" Zeri nr.5,6.
10	Betoniere 500l	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni "Punime ne rruge" Zeri nr.9. Seksioni "Punime ne trotuar" Zeri nr.3. Seksioni "Punime ne kanal" Zeri nr.6.
11	Armatura	100 m ²	Në pronësi ose me qera	Seksioni "Punime ne rruge" Zeri nr.9 Seksioni "Punime ne trotuar" Zeri nr..3
12	Vinc kulle	1 cope	Në pronësi ose me qera	Seksioni "Punime ne kanal" Zeri nr.7.
13	Fabrike asfaltobetonit jo me larg se 70 km nga objekti (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur eshte ne pronesi)	1 cope	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Seksioni "Punime ne rruge" Zeri nr.7,8.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certificate/licence transporti si dhe kontraten përkatëse të qerave dhe licencën e transportit për të tretet (nese eshte me qera), e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave e cila duhet të përshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

b) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklaron se drejtuesit teknik të përfshirë në licencën e zbatimit të punimeve, të shoqërisë së tij nuk janë të punësuar në asnjë institucion shtetëror.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe pajisjet e mesipërme janë kërkuar duke u bazuar në zërat përkatës të preventivit, sipas tabelës së mesipërme.

2.3.9 Ofertuesi duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vëlosur nga administratori. Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”..